

Pkl-Kzz 114/09

12 prill 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

në kolegjin e përbërë nga

Maria Giuliana Civinini gjyqtare e EULEX-it në Gjykatën Supreme dhe Kryetare e Kolegit,

Gerrit Marc Sprenger gjyqtar i EULEX-it në Gjykatën Supreme – anëtar i kolegit
Enver Peci, gjyqtar i Gjykatës Supreme - anëtar i kolegit

Valdete Daka, gjyqtare e Gjykatës Supreme - anëtare e kolegit

Avdi Dinaj, gjyqtar i Gjykatës Supreme - anëtar i kolegit

Asistuar nga Edita Kusari si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të pandehurës:

L. XH. e lindur në, më, emri i të atit,
mbiemri i vajzërisë i së ëmës, me vendbanim në Rrugën
në Prishtinë, Shqiptar i Kosovës, ekonomiste, e martuar, ka tre fëmijë, ka të kryer
fakultetin ekonomik, me gjendje të mesme ekonomike;

Për veprën penale **Shpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit** si bashkëkryes me të
dyshuar të tjerë kundër të cilëve është paraqitur aktakuzë e veçantë, në kundërshtim të
nenit 25 të KP RSFJ-së dhe nenit 210, paragrafët (1) dhe (4) të LPK-së, dhe për veprën
penale **Lidhja e kontratës së dëmshme**, në kundërshtim të nenin 109, paragrafët (1) dhe
(2) të LPK-së;



Duke vendosur mbi kërkësen për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës Tomë Gashi në dobi të së pandehurës L. 244. drejtar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr. 826/06 të datës 09.05.2008 dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.Kz. Nr. 435/2008 të datës 22 qershori 2009 në seancën e mbajtur më 12 prill 2009 pas këshillimit dhe votimit;

Lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohet Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë c avokatit mbrojtës Tomë Gashi e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr. 826/06 të datës 09.05.2008 dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.Kz. Nr. 435/2008 të datës 22 qershori 2009

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

Më 9 maj 2008 Gjykata e Qarkut në Prishtinë shpalli fajtore si bashkëkryese me të dyshuar tjerë kundër të cilëve është paraqitur Aktakuzë e veçantë për vepër penale Shpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit, në kundërshtim të nenit 25 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe nenit 210 paragrafët (1) dhe (4) të LPK-së, dhe po ashtu fajtore për veprën penale Lidaja e kontaktes së



dëmshme, në kundërshtim të nenit 109, paragrafët (1) dhe (2) të LPK-së. L.. XH.. morri një dënim unik prej 4 vjetësh burgim.

Brenda afatit ligjor, avokati mbrojtës Tomë Gashi paraqiti ankesë në dobi të së pandehurës Leme Xhemë më 6 gusht 2008.

Më 22 qershor 2009 Gjykata Supreme e Kosovës pjesërisht pranoi ankesën e avokatit mbrojtës të paraqitur në dobi të L.. XH.. dhc pjesërisht vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Me aktgjykimin e Gjykatës Supreme e pandehura L.. XH.. u dënuua me tre (3) vjet burgim dhe cilësimi juridik i fakteve u ndryshua sa të jetë vetëm për Pikën 2 pasi që Gjykata Supreme konstatoi se krimi i paraparë në Pikën 2 konsumon dhe përfshin faktet e “Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit” të paraparë në Pikën 1.

Më 23 tetor 2009 kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ishte paraqitur me kohë nga avokati mbrojtës Tomë Gashi, në dobi të së pandehurës, kundër aktgjykimit të GjQ në Prishtinë P.nr. 826/06 të datës 09.05.2008 dhe aktgjykimit të GjS të Kosovës Ap.Kz nr. 435/2008 të datës 22.06.2009.

Më 10 nëntor 2009 Prokurori i Shtetit paraqiti një propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të refuzohet si e pabazuar.

Më 16 mars 2010 avokati mbrojtës Bejtush Isufi paraqiti në Gjykatë Supreme të Kosovës një plotësim të shkurtër në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.



2. Arsyetim

Ligjshmëria e dispozitivit të shkallës së parë dhe atij të shkallës së dytë

Avokati mbrojtës vërteton se të dy aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë përmbajnë shkelje esenciale të rregullave të procedurës; në veçanti dispozitivi i dy aktgjykimeve do të ishte i pakuptueshëm, kundërthënës në përmbajtje me arsyet e aktgjykimit.

Lidhur me dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më 9 maj 2008, avokati mbrojtës paraqet se në dispozitiv aktgjykimi konstaton se L. ~~XVII~~ si Drejtoreshë e Përgjithshme e PTK-së më 28 shkurt 2003 urdhëroi pagesën e €300,000.00 ti paguhen Norway Invest-it për ti mbuluar të gjitha shpenzimet e pretenduara për themelimin e kompanisë së përbashkët të quajtur ARTET. Derisa ne arsyetim aktgjykimi përmend se kjo shumë e parave është paguar për shërbimet që në fakt nuk janë kryer dhe përkundër faktit që PTK-ja nuk ka qenë e obliguar për të paguar një shumë të tillë. Më tutje, dispozitivi përmend se kjo shumë është paguar pa autorizimin e AKM-së e cila është në kundërshtim – sipas avokatit mbrojtës – me deklaratën tjeter në dispozitiv e cila thotë se L. ~~XVII~~ ka vepruar në bashkëpunim me Roger Reynoldsin i cili ka qenë menaxher i AKM-së përgjegjës për sektorin e PTK-së. Lidhur me mospërputhjen e aktgjykimit me arsyetimin e tij, mbrojtja shton se derisa në dispozitiv kolegji ka konstatuar se L. ~~XVII~~ ka vepruar së bashku me Roger Reynoldsin, në pjesën e arsyetimit aktgjykimi tregon se L. ~~XVII~~ nuk ishte e obliguar të veprojë sipas urdhërave të Reynoldsit pasi që këto urdhra ishin të kundërligjshëm.

Lidhur me dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme të 22 qershorit 2008, avokati



mbrojtës argumenton se përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara me nenin 403 par. 1 pikën 12 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), pasi që aktgjykimi është i pakuptueshëm, kundërthënës me përbajtjen e tij dhe arsyetimin. Në arsyetim (faqe 6 të versionit në shqip) kuptohet se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut është ndryshuar dhe e pandehura është shpallur fajtore vetëm për pikën 2 të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinës (lidhja e kontratës së dëmshme) kurse nuk përmendet se si GjS ka vendosur për veprën penale nën pikën 1 për shpërdorim të detyrës zyrtare ose autorizimit.

Mendim i Gjykatës Supreme është se kushtet e përgjithshme ligjore të dispozitivit si pjesë e aktgjykimit duhet të sqarohen:

- a) aktgjykimi i shkallës së parë duhet të përbajë hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin (neni 396 par 1 i KPPK-së); dispozitivi do të përfshijë të dhënat personale, vendimin (dënim apo lirim) dhe në rast të dënimit: akti për të cilën i pandehuri është shpallë fajtor me indikacionin e vepërës penale relevante dhe faktet dhe rrëthanat esenciale si dhe dënimin (neni 396 par. 3 dhe 4 lidhur me nenin 391 të KPPK-së); arsyetimi duhet të paraqesë bazën faktike dhe ligjore të vendimit, vlerësimin e provave, rrëthanat që janë relevante për dënimin (neni 396 par. 6 deri në 10).
- b) aktgjykimi i ankimuar ka të njëjtën strukturë sikur të atij të shkallës së parë (hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin); dispozitivi përfshin të dhënat personale dhe vendimin (ankesa që hedh poshtë ose refuzon, anulon ose ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë – nen 420 i KPPK-së).
- c) aktgjykimi konsiderohet si unik me nenet 402 dhe 403 të KPPK-së “në bazi të cilës aktgjykimi mund të kundërshtohet”.



- d) bazuar në nenin 403 par. 1 pikën 12, aktgjykimi mund të kundërshtohet mbi bazën e shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nëse “dispositivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm ose kundërthënës në brendinë e tij ose kundërthënës me arsyet e aktgjykimit...”.
- e) duke e marrë parasysh se dispositivi është pjesë integrale e aktgjykimit duhet të lexohet dhe interpretohet në lidhje me pjesët tjera të aktgjykimit posaçërisht me arsyetimin.
- f) bazuar në parimin e përgjithshëm që një vepër mund të interpretohet në mënyrë në të cilën ka kuptim dhe jo në mënyrë në të cilën nuk ka kuptim, dispozitivi dhe arsyetimi duhet të lexohen së bashku (ligji përcakton që ato duhet të janë në përputhje me njëra tjetrën); vetëm nëse dispositivi mbetet i pakuptueshëm ose kundërthënës pasi të ketë qenë lexuar në lidhje me arsyetimin, mund të shpallet i kundërligjshëm dhe aktgjykimi mund të anulohet
- g) përfundimi gjithashtu bazohet në parimin e ekonomisë gjyqësore e cila duhet të aplikohet duke e pasur parasysh qëllimin e sistemit të zgjidhjes së kontesteve. Qëllimi është të zgjidhet çështja në fjalë dhe “të sigurohet një zgjidhje pozitive e kontestit”. Në vlerësimin e pretendimeve të gabimeve ligjore, duhet të merret parasysh nëse të gjitha elementet e aktgjykimit të kërkua me ligj janë të pranishme në vendimin e kundërshtuar. Të anulohet dhe kthehet për rigjykim një aktgjykim që nuk përbën elemente ose informata të cilat mund të gjenden lehtësisht në arsyetim do të ishte kundër parimit të lartpërmendur.

Në aplikimin e këtyre parimeve për rishqyrtimin e lëndës, Gjkata Supreme mendon se:

- 1) dispositivi i shkallës së parë është i qartë, i shkruar mirë dhe plotësishë i kushtosë;



përveç kësaj përmban të gjitha elementet dhe treguesit e përcaktuar me ligj dhe është në përputhshmëri me brendinë e tij.


Avokati mbrojtës është munduar ta demonstrojë mospërputhshmërinë e dispozitivit me arsyetimin, duke iu referuar përshkrimit të pagesës dhe rolit të Roger Reynoldsit. Është thënë në dispozitiv dhe është sqaruar shumë mirë në arsyetim mbi bazat e vlerësimit korrekt të provave që pagesa e 300.000,00 eurove ishte autorizuar nga e pandehura për faturën 301001 të Kompanisë Norvegjeze Norway Invest R&O AS për PTK-në duke e mbuluar “ARTET zhvillimin e biznesit & vendosjen e plotë nga 1 qershori 2002 deri më 10 mars 2003”, ARTET duke qenë kompani (jo e themeluar në datën e gjykimit) supozohet të është bërë kompani e përbashkët në mes të PTK-së dhe Norway Investit SA me qëllim të prezantimit të shërbimeve të komunikimit TETRA në Kosovë (shih memorandumin e mirëkuptimit më 20.11.2002 në mes të PTK-së dhe Norway Invest SA). Paratë janë transferuar nga xhirollogaria e PTK-së në një nën-xhirollogari PTK-ARTET të hapur nga vetë e pandehura dhe të administruar nga Reynolds si menaxher i ARTET ndërmarrjes së përbashkët. Asnjë provë nuk është dhënë lidhur me shërbimet të cilave u referohet fatura dhe kjo mund të konfirmohet si inekzistente. Lidhur me rolin e Reynoldsit, nuk ka kundërthënie në mes të rolit të tij si menaxher i AKM-së, funksionit të tij të mbikëqyrjes së PTK-së dhe rolit të tij si bashkëkryes për natyrën e kundërligjshme të veprimit dhe marrëveshjes në mes të L. XH. dhe Reynoldsit. Ajo që është shkruar në dispozitiv (“Ajo ka vepruar së bashku me Roger Reynoldin i cili ka nënshkruar urdhrin për transferim në cilësi të dyfishtë të përfaqësuesit të AKM-së dhe kryesuesit të ARTET”) është pasqyruar në arsyetim ku është sqaruar mbi bazë të provave se urdhri për transferimin e parave nga xhirollogaria e PTK-së në xhirollogari e PTK-



ARTET ishte nënshkruar (pa e pasur autorizimin e duhur ligjor) nga L. V. dhe nga Reynoldsi për të paraqitur si të ligjshëm operacionin dhe për të bindur Drejtorin e Financave të PTK-së, L. V. për ta nënshkruar urdhrin në mungesë të faturës origjinale.

Lidhur me pikën e kontratës të ngritur nga avokati mbrojtës që vërteton se asgjë nuk është thënë në arsyetim për lidhjen e saj, vërtetohet qartë në vendim (faqe 28-29 në versionin në gjuhën angleze) se: "Kontrata është lidhur me pajtimin e palëve kontraktuese përkitazi me përbërësit kryesorë të kontratës. Vullneti për të lidhur kontratë mund të shprehet me çfarëdo sjellje nga e cila mund të konstatohet përtej çdo dyshimi se vullneti ekziston. Oferta konsiderohet e pranuar kur të paguhet çmimi. (...) Kur Norway Invest SA dërgoi faturën më 15.01.2003... me një gjë të tillë ata bënë ofertën përkitazi me shitjen e shërbimeve. Duke paguar këtë faturë, L. V. në të vërtetë ka pranuar ofertën duke lidhur me të kontratën."

2) Dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Supreme është i qartë dhe i kuptueshëm; është e vërtetë se nuk përmban arsyetim apo nuk janë paraqitur arsyet që lidhen me faktet vendimtare" por KPPK-ja është e qartë duke vërtetuar që arsyet e këtij vendimi duhet që të jepen në arsyetim dhe jo në dispozitiv. Në arsyetim (pika 4) thuhet: "Gjykata Supreme konstaton se faktet e vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë dhe të konfirmuara në ankesë, duhet që juridikisht të cilësohen dhe të identifikohen vetëm në pikën 2, sepse vepra e paraparë në pikën 2 konsumon dhe përfshin faktet e "Shpërdorimit të pozitës zyrtare apo të autorizimit", të parapara në pikën 1" (sqarimi juridik dhe faktik vijon).



përmendja e konsumimit të pikës 1 me pikën 2 në dispozitiv nuk është relevante.

Ligjshmëria e provave

Mbrojtja argumenton se aktgjykimi i GjQ Prishtinë përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 par. 1, pika 8 e KPPK-së, pasi që aktgjykimi mbështetet në prova të papranueshme siç është kopja e MM-së e paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është paraqitur asnjë faturë origjinale për 300.000 euro, në faqen 11 të aktgjykimit të GjQ-së në Prishtinë në gjuhën shqipe provat që nuk janë lexuar fare gjatë shqyrtimit gjyqësor konsiderohen si procesverbal i shqyrtimit gjyqësor.


Kopjet e Memorandumit të mirëkuptimit të arritur në mes të PTK-së dhe të Norway Invest SA dhe të faturave janë dorëzuar nga Prokurori në mënyrë të rregullt si prova të dokumentuara, të përdorura për marrjen në pyetje të dëshmitarëve gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe avokati mbrojtës apo vetë e pandehura kurrë nuk kanë paraqitur asnjë kundërshtim apo vërejtje. Sa i përket faturës, gjatë gjykimit është bërë e qartë (dhe është paraqitur në aktgjykim) se origjinali i faturës është zhdukur pas dërgimit të saj tek L.

Ylli, nga ana e drejtorit financiar I. L.

Të gjitha dokumentet e komunikuar nga Prokurori për të pandehurën janë konsideruar si të lexuara në procesverbal në seancën gjyqësore të datës 14 prill 2008.

Kërkesa për ekspertizë financiare dhe për dëshmitarë

Mbrojtja argumenton se refuzimi i gjykatës pa asnjë justifikim parabërë kohën e kërkesën e mbrojtjes për angazhimin e ekspertëve financiarë për përcaktimin e shumës së



pohuar të dëmit të shkaktuar, përbën shkelje të nenit 403, par. 2 , pikës 2 të KPPK-së. Ka një numër dëshmitarësh për të cilët mbrojtja propozon të dëgjohen me qëllim të sqarimit të çështjes së biznesit, e cila sipas mbrojtjes konsiderohet padrejtësisht si vepër penale në dëm të L. V.

Nuk ka pasur nevojë për ekspertizën financiare për caktimin e shumës së dëmit të shkaktuar të PTK-së. Është e qartë se dëmi është së paku i barabartë me shumën e parave të paguara pa konsideratë. Vendimi për të nënshkruar transferimin e parave në emër të L. V. nuk ka nevojë për vlerësim të ekspertit në prani të dokumentit që tregon se e pandehura si Drejtor i përgjithshëm i PTK-së për kontratat mbi 25,000 euro kërkon miratimin dhe nënshkrimin e Drejtorit të përgjithshëm pas dhënies së pëlqimit nga Drejtoria e Çështjeve të Infrastrukturës/Komunikacionit – DÇI/K të UNMIK-ut, dhe pëlqimit që më vonë është dashur të jetë dhënë nga AKM-ja.

Duke marrë parasysh faktet e kufizuara të cilat janë të rëndësishme për veprën penale me të cilën ngarkohet e pandehura, dëshmitarët e kërkuar nga mbrojtja nuk janë të rëndësishëm.

Plotësim i shkurtër i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

Në plotësimin e shkurtër të kërkesës së avokatit mbrojtës Bejtush Isufi në dobi të të pandehurës kërkohet lirimi nga akuzat ose alternativisht kthimi i lëndës për gjykim të ri në GjQ. Mbrojtja argumenton se GjS me akt gjykimin e saj ka shkelur nenin 451, par. 1, pikën 1 dhe 2, nenin 458 dhe 403, par. 1 të KPPK-së. Mbrojtja më tej shtjellon se nuk është dëshmuar që e pandehura ka vepruar “me dashje të përfitimit të paligjshëm të dobisë pasurore” siç përcaktohet për veprën penale të shpërdorimit të pozitës së drejtore së



autorizimit dhe as “që ka ditur se një gjë e tillë do ta dëmtonte biznesin”, siç përcaktohet për veprën penale të lidhjes së kontratës së dëmshme pasi që ajo po vepronë nën mbikëqyrjen e Roger Reynolds i cili asokohe ishte menaxher i PTK-së në AKM dhe mbikëqyrës i saj. Edhe pse e pandehura e pranon se i kishte tejkaluar autorizimet e saj për transferimin e parave (sepse kufiri i transferimit ishte 25.000 euro, ndërsa ajo kishte transferuar 300.000 euro), ajo besonte se pasi që po vepronë nën mbikëqyrjen e Reynolds, po bënte gjënë e duhur). Më tej, e pandehura kërkon që dënim i tij të pezullohet derisa të merret vendimi mbi kërkesën.

Përbledhja plotësuese është dorëzuar pas skadimit të afatit për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, prandaj arsyet e ngritura në të nuk ka nevojë që të merren parasysh.

Në përfundim, pohimi se Aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Supreme përmban gabime juridike, është i pabazë prandaj kërkesa si e tillë duhet që të refuzohet.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Më 12 prill 2010, Pkl-Kzz 114/09

Procesmbajtëse,
Edita Kusari

Kryetari i Kolegjit
Maria Giuliana Civinini

Anëtarët e Kolegjit

Gerrit Marc Sprenger

Enver Peci,



Republika e Kosovës
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAÇNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Avdi Dinaj

Republika Kosovo
Valdete Daka

Punëtori i autorizuar
Ovlašteni rednik